



NJOFTIM

Nr. 625, datë 24.4.2018

**PËR PROCEDURËN E KONKURRIMIT
“TENDER I HAPUR KOMBËTAR”,
ME OBJEKT: “RIKONSTRUKSION DHE
ZGJERIM I RRUGËS “MUZAK TOPIA”,
SEGMENTI NGA RRETHRROTULLIMI
TEK ISH-REZERVAT E SHTETIT DERI
TE LABIDARI NË KALA”, FINANCUAR
NGA BANKA BOTËRORE**

FTESË PËR OFERTË**Shqipëri**

**Projekti për integrimin urban dhe zhvillimin
e turizmit**

Hua nga IBRD-ja nr. 8656- ALB

**Titulli i kontratës: “Rikonstrukcion dhe
zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga
rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te
lapidari në kala”**

Referencë: AL – ADF – 15545 – CW – RFB

Lëshuar në datën: 25 prill 2018

1. Qeveria e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore kundrejt kostos së projektit: **“Integrimi urban dhe zhvillimi i turizmit”** dhe ka për qëllim të përdorë pjesë të këtij financimi për kontratën **“Rikonstrukcion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te lapidari në kala”**.

2. Fondi Shqiptar fton tani ofertues të kualifikuar për të paraqitur ofertat e tyre për punimet civile, **“Rikonstrukcion dhe zgjerim i rrugës “Muzak Topia”, segmenti nga rrethrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te lapidari në kala”**, që parashikohen të kryhen për një periudhë kohore prej 12 muajsh.

3. Tenderi do të zhvillohet në bazë të një dokumentacioni të harmonizuar ndërmjet dokumentacionit për prokurimin e tenderit të hapur sipas Agjencisë së Prokurimit Publik dhe standardeve të Bankës Botërore, duke u realizuar sipas procedurave të përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore, për: *“Prokurimi i mallrave, punët dhe shërbimet jokonsultuese nën Huat IBRD dhe kreditë IDA & grantet nga huamarrësit e Bankës Botërore”*.

Ju lutemi, referojuni paragrafëve 1.6 dhe 1.7 për politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.



4. Ofertuesit/kompanitë e interesuar/a mund të marrin informacion më të detajuar nga **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)** dhe të kontrollojnë dokumentet e tenderimit gjatë orareve zyrtare nga 09:00 deri 16:30, në adresën e dhënë më poshtë:

Emri: Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Tel.: +355 4 2235 597/8

Fax: +355 4 2234 885

E-mail: eqirjaqi@albaniandf.org

Adresa e internetit: <http://www.albaniandf.org>

5. Një set i plotë i dokumenteve të tenderimit në shqip mund të blihet nga ofertuesit e përshtatshëm të interesuar, sipas paraqitjes së një aplikimi të shkruar në adresën e mëposhtme dhe sipas pagesës së një takse të pakthyeshme prej 15,000 ALL. Mënyra e pagesës do të jetë me transfertë bankare, në favor të:

Emri i llogarisë: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Emri i bankës: Union Bank

Emërtimi i llogarisë: Llogari Projekti ADF

Numri i klientit: 285464

IBAN CODE: AL80 2141 1106 0111 2854 6403 0117

6. Ofertat duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme në ose para **25.5.2018, ora 10:00**. Ofertat elektronike nuk do të lejohen. Ofertat e vonuara do të refuzohen. Ofertat do të hapen

publikisht në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të ofertuesve dhe kujtdo që zgjedh të marrë pjesë, në adresën e mëposhtme, më **25.5.2018, ora 10:00**.

7. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen nga një sigurim oferte me vlerë **5,750,000 lekë (pesë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë)**.

8. Adresa/at e referuar/a më sipër është/janë:

Emri: Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)

Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë

Tel.: +355 4 2235 597/8

Fax: +355 4 2234 885

E-mail: eqirjaqi@albaniandf.org

Adresa e internetit: <http://www.albaniandf.org>